



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 156, datë 13.11.2020

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit 95/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632;ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", pikës 2 të nenit 3/dh të ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit", i ndryshuar, VKB nr. 88, datë 29.12.2016 "Për likuidimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Funerale", i ndryshuar, udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe rekomandimit nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditit të brendshëm të Bashkisë Tiranë dërguar me nr.prot 32770 datë 09.12.2019, si dhe në vijim të shkresës nr. 5/111 prot., datë 07.07.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, bëhen disa shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 8 "Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës", bëhen këto ndryshime si më poshtë:

a. Pika 8, ndryshohet si më poshtë:

8. Ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim të kryefamiljarëve që përfitojnë vetëm pension pleqërie ose pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë".

b. Në pikën 10, në fund të fjalisë shtohen fjalët “të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse”.

2. Në nenin 75 “Tarifa e shërbimit funeral”, aneksi nr. 11, zëvendësohet sipas aneksit nr. 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Pavarësisht përcaktimeve të këtij vendimi, për mbajtësit e kartës së studentit aplikohen tarifat/përrjashtimet sipas vendimit nr. 64, datë 07.06.2019 të këshillit bashkiak “Për ofrimin e shërbimeve që përfitohen falas apo me çmime të reduktuara në bashkinë e Tiranës nga përdorimi i kartës së studentit”.

4. Përrjashtimin nga pagesa e taksës së përrkohshme të infrastrukturës arsimore dhe tarifa e pastrimit të gjithë adresat sekondare të regjistruara në QKB në datën 26.09.2019 me përrshkrimin “Burim fshati”, “Depo uji” dhe “Stacion pompimi”, etj në pronësi të Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha.

5. Në nenin 23, "Baza e taksës", në pikën 3, shkronja "c", fjalia e dytë shfuqizohet.

6. Ngarkohen Drejtoria e Përrgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përrgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përrgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjencia e Shërbimit Funeral dhe Agjencia e Parqeve Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përrcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

ZV/K R Y E T A R

ROMINA KUKO

Aneksi nr. 11: Tarifat e shërbimit funeral

| Nr | Emërtimi | Qyteti Tiranës | NJA = Dajt, Farkë, Kashar (-20 %) | NJA = Bërzhitë, Baldushk, Vaqarr, Petrelë, Pezë, Ndroq, Krabë, Shëngjergj, Zall- Herr, Zall- Bastar (-50%) |
|----|---|-------------------|---|---|
| 1 | Tarifa për një shërbim varrim për të rritur | 24,000 | 19,200 | 12,000 |
| 2 | Tarifa për një shërbim varrim për të rritur varr mbi varr | 27,000 | 21,600 | 13,500 |
| 3 | Tarifa për një shërbim varrim për të mitur (Arkivol+ autofunebër) | 19,000 | 15,200 | 9,500 |
| 4 | Tarifa për një shërbim varrim për të mitur i thjeshtë | 9,000 | 7,200 | 4,500 |
| 5 | Tarifa shërbimi për mirëmbajtje të veçantë Varri (larje varri, ujitje lule) | 150 | 150 | 150 |
| 6 | Tarifa për hapje – mbyllje varri për të rritur | 6,500 | 5,200 | 3,250 |
| 7 | Tarifa për hapje – mbyllje varri për të rritur e nxjerrje kufome | 10,200 | 8,160 | 5,100 |
| 8 | Tarifa për hapje – mbyllje varri për femije | 3,000 | 2,400 | 1,500 |
| 9 | Tarifa për hapje – mbyllje varri e nxjerrje kufome per femije | 4,000 | 3,200 | 2,000 |
| 10 | Tarifa për transport me auto funebër brenda qytetit | 5,000 | 4,000 | 2,500 |
| 11 | Tarifa për transport me auto funebër jashtë rrethit për 1 km | 150 | 120 | 75 |